



Në pajtim me nenin 47, paragrafi (1), pika 6) nga Ligji i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.58/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16) dhe nenin 65-g, paragrafi (1) nga Ligji i Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15 dhe 190/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, miratoi

VENDIM

për metodologjinë e përcaktimit të lartësisë së shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përshkruhet metodologjia mbi bazën e së cilës Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëposhtëm: Banka Popullore) e vendos normën e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit të rezidentëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: ekspozime në Republikën e Maqedonisë së Veriut), që përfshin:

- përcaktimin e lartësisë së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- mënyrën e prezantimit dhe ndryshimet në normën e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Përkrah metodologjisë në paragrafin (1) të kësaj pike, me këtë vendim përshkruhet edhe mënyra e llogaritjes së normës specifike të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit dhe mënyra e paraqitjes së të dhënave deri te Banka Popullore për lartësinë dhe strukturën e saj.

2. Termat që nuk janë përcaktuar në këtë vendim kanë kuptimin e përcaktuar me Ligjin e Bankave dhe rregulloren e Bankës Popullore me të cilat rregullohet metodologjia për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

II. PËRCAKTIMI I NORMËS SË SHTRSESË MBOJTËSE KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT TË EKSPOZIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

3. Norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike e kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut vërtetohet përmes hapave në vijim:

- vërtetimit për raportin në mes të kredive në sektorin jofinanciar dhe prodhimit të brendshëm bruto (në tekstin e mëtejme: norma e kredive), në pajtim me pikën 4) të këtij vendimi:

- përcaktimit të devijimit të normës së kredisë nga tendenca e saj afatgjate (në tekstin e mëtejshëm: devijimi i normës së kredive), në pajtim me pikën 5) të këtij vendimi;
- vërtetimit të normës referente të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit, në pajtim me pikën 6) të këtij vendimi;
- vërtetimit të nivelit të normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në pajtim me pikën 8) të këtij vendimi.

4. Norma e kredisë për çdo tremujor (T) llogaritet si raport i kredive ndaj sektorit jofinanciar dhe produktit të brendshëm bruto nominal, duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$\text{Norma e kredive}(T) = \left(\frac{\text{Kredi në sektorin jofinanciar}(T)}{(\text{PBB}(T - 1) + \text{PBB}(T - 2) + \text{PBB}(T - 3) + \text{PBB}(T - 4))} \right) \times 100$$

5. Devijimi i normës së kredisë për çdo tremujor(T) llogaritet si diferencë ndërmjet normës së kredisë nga pika 4) e këtij vendimi dhe trendit(T), duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$\text{Devijimi i normës së kredisë}(T) = \text{Norma e kredive}(T) - \text{Trendi}(T)$$

Trendi (T) në këtë formulë nga paragrafi (2) i kësaj pike paraqet vlerën mesatare të normës së kredive, të llogaritur përmes përdorimit të filtrit të njëanshëm Hodrik-Preskotov me parametër të barabartë me 400.000 për tremujorin (T).

Devijimi i normës së kredisë nga paragrafi (1) nga kjo pikë shprehet në pikë përqindje.

6. Përderisa devijimi nga norma e kredive nga pika 5) e këtij vendimi është e njëjtë apo më e vogël se 2 pikë përqindje (kufiri i poshtëm), norma referente e shtresës mbrojtëse kundërciklike e kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut shënon 2,5%.

Përderisa devijimi nga norma e kredive nga pika 5) e këtij vendimi është i njëjtë apo më i madh se 10 pikë përqindje (kufiri i sipërm), norma referente e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut shënon 2,5%.

Përderisa devijimi i normës së kredive nga pika 5) e këtij vendimi është në mes kufirit të poshtëm dhe të sipërm të paragrafit (1) dhe (2) të kësaj pike, norma referente e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë përcaktohet me përdorimin e kësaj formule:

$$\text{Norma referente e SHMKT} = \text{Devijimi}(T) \times 0,3125 - 0,625$$

7. Banka Popullore e përcakton normën referente të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga pika 6) e këtij vendimi në baza tremujore.

8.8. Në varësi të lartësisë së normës referente të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, të përcaktuar në pajtim me pikën 6) të këtij vendimi, Banka Popullore e përcakton normën e nevojshme të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit nga paragrafi (1) të kësaj pike lëviz prej 0% deri 2,5% dhe shprehet në intervale prej 0,25 pikë përqindje.

Me përjashtim, përderisa vërtetohet se është e nevojshme gjatë përcaktimit të lartësisë së normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit nga paragrafi (1) i kësaj pike, Banka Popullore mund të merr parasysh edhe tregues të tjerë për nivelin e rreziqeve sistematike, si treguesit e tregjeve financiare, tregu i patundshmërive, rezistenca e sistemit bankar, ekonominë vendase dhe të ngjashme.

Në bazë të treguesve nga paragrafi (3) i kësaj pike, Banka Popullore mund të caktojë normë të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, më të lartë se 2,5%.

III. METODA E PARAQITJES DHE NDRYSHIMIT TË NORMËS SË SHTRRESËS MBROJTËSE KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT TË EKSPOZIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

9. Duke patur parasysh normën e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të caktuar në pajtim me pikën 8) të këtij vendimi, Banka Popullore në baza tremujore do të përcaktojë nëse ka nevojë të mos futet, të futet, të rritet, të zvogëlohet ose të lirohet shtresa mbrojtëse kundërciklike e kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

10. Gjatë përcaktimit se nëse ka nevojë të mos futet, të futet, të rritet, të zvogëlohet ose të lirohet shtresa mbrojtëse kundërciklike e kapitalit e përmendur në pikën 9) të këtij vendimi, Banka Popullore mund të marrë parasysh edhe tregues të tjerë të nivelit të rreziqeve sistematike, si treguesit për tregjet financiare, tregun e pasurive të paluajtshme, rezistencën e sistemit bankar, ekonominë vendase, etj.

11. Në bazë të nevojës së konstatuar nga pika 9) e këtij vendimi, Këshilli i Bankës Popullore do të miratojë vendim për shumën e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, në të cilin duhet të specifikohen së paku:

- data nga e cila bankave u kërkohet të zbatojnë normën e shtresës mbrojtëse kundërciklike, në rast të futjes ose rritjes së tij;
- data nga e cila është ulur norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike e kapitalit ose nga e cila është hequr kërkesa për shtresën mbrojtëse kundërciklike, duke u marrë parasysh përcaktimet e pikës 12), paragrafi (1) i këtij vendimi;

- arsyet e përcaktimit të një date më të shkurtër të zbatimit, në rastet kur, me futjen ose rritjen e normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, përcaktohet datë zbatimi më e shkurtër se 12 muaj.

12. Në rast të zvogëlimit të normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ose në rast të heqjes dorë nga kërkesa e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ulja, përkatësisht heqja dorë, hyn në fuqi ditën e tetë nga data e publikimit të Vendimit për zvogëlimin, apo heqes dorë nga shtresa mbrojtëse kundërciklike e kapitalit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Banka Popullore e publikon normën e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit në faqen e saj të internetit, në pajtim me ligjin.

IV. MËNYRA E LLOGARITJES SË NORMËS SPECIFIKE TË SHTRSESË MBROJTËSE KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT TË SECILËS BANKË

13. Banka është e detyruar të vendos normë specifike të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit.

14. Norma specifike e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit paraqet mesatare të ponderuar të normave të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit të bankave ndaj klientëve nga sektori privat nga të gjithë vendet ndaj të cilave banka ka ekspozim, duke përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në përcaktimin e normës specifike të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit përfshihen ekspozimet ndaj klientëve në sektorin privat të të gjithë vendeve, pa dallim të lartësisë së normës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit të atij vendi.

Norma specifike e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit përcaktohet me përdorimin e formulës së mëposhtme:

$$\text{Norma specifike} = \frac{\sum_{i=1}^H (S_3 \times \text{KPKR}_3) \text{KPKR}}{\quad} \times 100$$

Termet e formulës nga paragrafi (2) të kësaj pike, e kanë këtë kuptim:

- S3 është norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike për ekspozimet ndaj shtetit 3, e publikuar me vendim të Këshillit të Bankës Popullore;

- KPKR3 është kapitali i nevojshëm për mbulim të rrezikut kreditor për ekspozimet ndaj klientëve të sektorit privat të vendit 3, përcaktohet në pajtim me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit;

- KPKR është vlera e përgjithshme e kapitalit të nevojshëm për mbulim të rrezikut kreditor për të gjithë ekspozimet ndaj klientëve në sektorin privat, e përcaktuar në pajtim me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Për nevojat e kësaj pike, ekspozimet ndaj klientëve nga sektori privat përfshijnë ekspozimet ndaj institucioneve financiare jobankare, amvisëritë dhe subjektet juridike jofinanciare, përfshirë edhe institucionet publike.

V. MËNYRA DHE PËRMBAJTJA E NJOFTIMIT TË BANKËS POPULLORE

15. Banka është e detyruar t'i paraqesë Bankës Popullore raport për shumën dhe strukturën e normës specifike të shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të përmendur në pikën 14) të këtij vendimi (formulari SSPPSK), të paktën në baza tremujore, më 31 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 31 dhjetor.

16. Afati për paraqitjen e raporteve të përmendura në pikën 15) të këtij vendimi është pesëmbëdhjetë ditë pune pas datës për të cilën është dorëzuar raporti.

Me përjashtim të paragrafit (1) të kësaj pike, afati për dorëzim të raportit nga pika 15) e këtij vendimi e 31 dhjetorit është pesë ditë pune pas përfundimit të afatit për dorëzim të raportit financiar vjetor të pa audituar.

Raporti nga pika 15) i këtij vendimi është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

VI. Dispozitat përfundimtare

17. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga data e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të filloj të zbatohet nga 1 qershori i vitit 2017.

V.nr. 02-15/II-8/2017
27 shkurt 2017
Shkup

Guvernatori
dhe kryesuesi i
Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Димитар Богов